

Leksiku i liturgjisë ofron një fushë të gjerë hulumtimi për studimet në fushë të disiplinave gjuhësore dhe filologjike. I parë në librin e Gjon Buzukut jo vetëm krijon mundësinë e një vështrimi të mirëfilltë sinkronik që analizon në mënyrë evidentuese dhe analitike një sërë përdorimesh dhe formash që rimerren rregullisht në pjesë të caktuara të librit (Oficja e Zojës, Psalmet, Meshari), por dhe bën të mundur përjasje me përdorime gjegjëse që në ndonjë rast dëshmojnë dhe shkallën e konsolidimit formal dhe semantik të tyre.

Qasjet realizohen dhe me veprat pasuese në pikëpamje kronologjike, në një pjesë të cilave mbarten të njëjtat përdorime, ndonjëherë me ndonjë ndryshim formal që arsyetohet me shpjegime të ndryshme, ndër të cilat do të merrnim parasysh dhe distancën kohore që ndan periudhën kur u realizua *Meshari* me vetë përpunimin gjuhësor dhe më tej daljen në dritë të shtypit të këtyre veprave.

Në disa prej tyre është e mundur të konstatohen dhe risi e përdorime që çojnë më tej variantet që gjinden në tekstet e Mesharit.¹

Në një trajtesë të kësaj natyre nuk mund të mos merret parasysh një traditë studimesh që dhe pse mund të kenë pasur objekt çështje të ndryshme që lidhen me përmbajtjen e librit, tiparet kryesore të ortografisë dhe shenjave përkatëse grafike, tipare të përgjithshme gjuhësore dhe të tjera aspekte të lidhura me këto çështje, kanë trajtuar në sythe të caktuara elemente të një leksiku specialistik siç është ai i liturgjisë në librin e Gjon Buzukut. Studiues të librit, kryesisht të lamijes së etimologjisë apo disiplinave historike të shqipes kanë bërë objekt studimi terminologjinë përkatëse të përdorur në të.

Këto studime që e kishin të pashmangshëm hulumtimin e drejtpërdrejtë të teksteve të librit, në përballjen me përmbajtjen dhe përdorimet gjegjëse në të njëjtat tekste biblike apo dhe në krahasimin me autorët pasardhës të Buzukut, së bashku me vënien në dukje të një sërë problemesh që lidhen mirëfilli me librin (autorësia apo dhe mospërkimet në elemente të caktuara

1 Risia në përdorimin e emërtesave të tjera dhe që lidhen me një çështje mjaft delikate që ka të bëjë drejtpërdrejt me një nomenklaturë të fushës së teologjisë, mund të vihet në dukje në autorë që janë gjithashtu përfaqësues të letërsisë së vjetër shqipe, por që në veprat përkatëse dëshmojnë për diferencime të qarta jo vetëm gjuhësore në krahasim me përdorimet në librin e Buzukut. Krahas këtij fakti do pasur parasysh dhe që ndërmarrja e tyre ka të bëjë me përpilime të ndryshme sa i takon vetë natyrën tekstologjike të veprës në fjalë.

tekstore) ndihmuan dhe në drejtim të gjurmimit të elementeve të leksikut të liturgjisë, leksikut të teologjisë dhe atij të krishterë e të parakrishterë.²

Për më tepër kërkimi i teksteve të tjera referenciale ka bërë që studiues të ditëve të sotme të çojnë më tej gjurmimet duke ripohuar çështjen e ndikimit të autorit nga variante të ndryshme, të shkruara në gjuhë të tjera. Kësisoj, historia e librit në fjalë është pasuruar me elemente që në fakt i japin një vizion tjetër duke e përfshirë atë në vetë historikun e studimeve mbi bibliofilinë mesjetare dhe historinë e botimeve të librave me përmbajtje nga shkrimet e shenjta pikërisht në atë periudhë historike.

Në studimet etimologjike të Eqrem Çabejt gjinden interpretime mbi përdorime kyçe të kësaj fushe. Dhe pse të përfshira në një korpus gjurmimesh që kanë objekt etimologjinë e një arsenali të gjerë leksikor të gjuhës shqipe, të tilla trajtesa zënë një vend të konsiderueshëm në përbërje të tyre. Veçojmë këtu trajtime apo citime bashkë me zbërthime në përbërje elementesh të disa përdorimeve nga kjo fushë, historia e të cilave çon natyshëm te Buzuku, Bogdani apo ndonjë autor tjetër.³

Përmendim gjithashtu përdorime që nuk ndeshen shpesh në libër si në rastin e Parakletit;⁴ përdorime që përbëjnë veçanti në drejtim të tipologjisë morfologjike me të cilën paraqiten në vepër, si në rastin e njëjësit Pashka dhe alternimeve të pakta në shumës; përdorimi vetëm i foljes *pagëz*oj në pjesë të caktuara të librit;⁵ përdorimin e fjalës *Ungjillë* qoftë në siglat introductive qoftë në brendi të ndonjë teksti biblik të Besëlidhjes së Re. Trajtimi i këtyre elementeve nga E. Çabej shërben në ndonjë rast dhe për të vënë në dukje bashkëpërkime përdorimi mes trajtave që ndeshen te autorët e vjetër dhe në toskërishte (jugore).⁶

Përmendja e modeleve të formimit të emrave të caktuar përfshin në fakt emërtesa themelore të teksteve të Mesharit. Përveç emrit të veprimit *bāsi*, të alternuar në të njëjtin libër me përdorime të tipit *autore*, tërheqin

2 Kjo metodë pune që bazohet gjerësisht në qasje tekstore dhe analiza elementesh të veçanta që përfshijnë dhe sintagma e tekste më të zgjeruara, karakterizon në veçanti Martin Camajn dhe Eqrem Çabejn, pavarësisht përkimit të mendimeve dhe rezultateve përfundimtare.

3 Shih në veçanti Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VII, Tiranë, 2006, f.53 në lidhje me shfaqjen e trajtave që emërtojnë Trininë shenjte. Citoen në vijimësi autorët kryesorë të kësaj tradite shkrimore, me gjithë modifikimet e mundshme formale të përdorimit të sipërcituar në gjuhën e gjithsecilit.

4 Për interpretimin e kësaj fjale që ndeshet te *Meshari*, por dhe në *Dicionarin latinisht-shqip*(1635) të F.Bardhit shih në veçanti Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VI, Tiranë, 2002, f.142.

5 Për përdorimin vetëm të foljes *pagëz*oj te Buzuku dhe trajtimin etimologjik të saj shih në veçanti Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VI, Tiranë, f.123. Të vihet re po aty dhe trajtimi i emrit *bagëm*, që përveç se te *Meshari* do të ndeshet gjithashtu dhe në variante kateketike të mëvona.

6 Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes I*, Tiranë, 1982, f.49.

vëmendjen në drejtim të modelit të formimit edhe emra të tjerë të tipit *shelbuos*⁷, *shpërbles*, *shkruos etj.*⁸ Një fakt i tillë shërben pikërisht për të shpënë më tej trajtimin e një vijimësie jo të rastësishme në përdorime të ngjashme dhe në pikëpamje kuptimore në variante kryesisht kateketike që e pasojnë librin e Buzukut në aspektin kronologjik.

Duhet vënë në dukje se pavarësisht se të tilla trajtesa u kanë shërbyer studimeve më të gjera gjuhësore apo kanë qenë përfshirë në punime që kanë pasur objekt studimi disa nënsisteme, përbëjnë kontribute të mirëfillta për hulumtimin e mëtejme të leksikut të krishterë, leksik që përfshin patjetër dhe prurje nga aspektet funksionale që kanë në përbërje të librit siglat e caktuara, incipitet e përsëritura e të rimarra rregullisht apo dhe në rubrika që kanë të bëjnë me festivitetin e paluajtshëm (Liturgia e Pashkëve). Në veçanti kjo çështje e fundit do parë me një vëmendje të veçantë në librin e Gjon Buzukut, për vetë tekstet specifike që janë përfshirë në këtë të fundit dhe për vetë impostimin që ndaj këtij argumenti mbahet në studimet mbi historinë e teologjisë së krishterë.⁹

Duke u parë në përmbajtjen e librit të Gjon Buzukut, leksiku i liturgjisë bëhet shtysë të gjurmohet në mënyrë graduale vijimësia e një sërë elementesh të rëndësishme në fushë të teologjisë biblike dhe në fushë të vetë praktikës së përdorimeve të caktuara të emërtesave që lidhen me këtë leksik. Gjithsesi, qasja sa herë e bie rasti apo sa herë duhet vënë në dukje fakti që ndonjë emërtim është ruajtur apo është shfaqur me ndonjë

7 *Meshari, botim kritik i cituar*, f.53-55/a : Oratio: O Jezu Krisht, *shelbuosi* i gjithë shekullit e *shpërble*si i shpirtënavet, Zot, regji i pāmort, u tÿ të lus, Dom Gjoni, sherbëtori uit, të madhenë zotën tande të pāfine për këta të kënduom të këtyne Psalme, qi u i pādenji këndova, ti të më liberojnsh shpirtinë tem n katit, e ti vëliz zemërënë teme përāpëtë n duorshit s atyne qi për të keq ecnjënë.

8 Prejardhja e tyre dhe rruga e depërtimit të tyre duhen kërkuar në tekstet referenciale të konsultuara. Por në këtë pikë ndërhyjnë patjetër dhe faktorë të tjerë që kanë të bëjnë dhe me traditën gojore të përdorimit të teksteve të caktuara, sidomos kur bëhet fjalë për lutje të shkurtra e të shpeshta në përdorim dhe në praktikën fetare të kohës.

9 Mbeten të një rëndësie të veçantë çështjet e dallimit thelbësor dhe të emërtimit të disa prej tyre e disa nocioneve, çështje që në këtë trajtesë shihet në veçanti në librin e Gjon Buzukut. Hulumtimi mbi leksikun e liturgjisë në këtë vepër komplekse mund të shihet dhe si inicim i një vëzhgimi më të kujdesshëm dhe më të sistemuar pa përjashtuar aspak dokumentet e mëparshme të njohura në një masë më të vogël për arsye të fragmentaritetit tekstologjik të tyre dhe për të cilat historianët e shkrimit shqip në përgjithësi mendojnë se i paraprijnë në pikëpamje kronologjike librit të Gjon Buzukut. Jemët të mendimit që gjurmimi i leksikut të liturgjisë në një model kompleks librash siç është rasti i librit të Gjon Buzukut (*livres d'heures et missel*, M.Roques, 1932, *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f.10), mbetet një hap i rëndësishëm në kërkimet që e kanë objekt qendror këtë argument. Kjo vepër do konsideruar si një pikë e qëndrueshme referimi dhe për faktin se në vetë strukturën e tij ai mbetet një libër që duhet të ketë synuar t'i përmbahet një kanoni, duke qenë se përmbante tekste dogmatike të liturgjisë kishtare të kohës.

ndryshim të konsiderueshëm, përbën një plotësim të domosdoshëm të kuadrit të përgjithshëm të trajtimit të argumentit. Ruajtja e gjatë e emërtimeve të caktuara duhet parë dhe në lidhje me dendurinë e përdorimit të disa teksteve, sidomos nëse bëhet fjalë për tekstet e lutjeve themelore të liturgjisë së orëve, tekste të cilat janë praktikuar sidomos në vise ku të tilla lutje janë thënë dhe mësuar në gegnishte.¹⁰

Në pikëpamje të studimit të leksikut të liturgjisë në këtë libër janë gjurmuar shfaqje emërtesash të posaçme, denduria e përdorimit të të cilave është më se e qartë. Do të veçonim emërtesat e perëndisë, pothuaj përherë në të njëjtën ecuri paradigmatiske dhe në pikëpamje morfologjike me mbizotërim trajtash sintetike të tipit *Zotynë*, *η Sinëzot*; kallëzoren shpesh shoqëruar dhe me parafralë si në rastin *m Tenëzonë*; çështja e dallimeve më specifike në këtë drejtim, (diferencime që siç dhe është vënë në dukje do të ndeshën në autorët pasardhës të Buzikut);¹¹ emërtime të elementeve të caktuara që kanë të bëjnë me objektet e kultit; emërtimet e vetë objekteve të tilla, gjurmuar në tekste specifike të librit.

Sa u takon emërtimeve të perëndisë të *Meshari*, duhet theksuar që bëhet fjalë për përdorime të shpeshta në përbërje të teksteve të librit, të ndeshura dhe në lutjet që shoqërojnë ritin e meshës në të; trajtat përkatëse janë kryesisht sintetike, përdoren vetëm në njëjës dhe mund të ndërtojnë një paradigme të veçantë; shembuj tipikë të pranisë së trajtave të ndryshme të kësaj paradigme gjinden në veçanti në pasthënien apo kolofonin e librit të Buzikut.¹² Përdorime të caktuara ndërkaq e bëjnë të domosdoshëm referimin ndaj varianteve të tjera referenciale, në të cilat dhe mund të gjenden emërtime më eksplicite dhe nganjëherë jo në përputhje të plotë me zgjidhjet që jepen në tekstet e Mesharit.¹³

10 Secili nga autorët e letërsisë së vjetër shqipe është përballur me sprovën e sjelljes në gjuhën e vet të emërtimeve të caktuara nga fusha e teologjisë dhe nga leksiku i liturgjisë. Formimi i tyre meshtarak sigurisht do t'u siguronte një parapërgatitje të domosdoshme në këtë drejtim. Kësaj rrethane i duhet shtuar dhe tradita e krishtërimit në vendin tonë dhe në veçanti në krahinat që njihen si vende të lindjes së secilit prej tyre. Shkalla e ngulitjes së përdorimit në praktikën fetare e disa elementeve të caktuara pasqyrohet dhe në veprat e këtyre autorëve.

11 *Meshari, botim kritik i cituar*, f.387: *U lus mbas sodi mā shpesh të uini m klishë, përse ju kini me gjegjunë ordhëninë e Tinëzot. E atë në mbarofshi, Zotynë të ketë mishërier mbī ju. E ata qī u monduonë djerie tash, ma mos u mondonjënë. E ju t ini të zgiedhunitë e Tinëzot. E përherë Zotynë kām me klenë me jū, ju tue ndjekunë të dërejtnë e tue lanë të shtrembënnë. E këta ju tue bām, Zotynë ka me shtuom ndër ju, se të korëtë taj të nglatetë djerie η së vjelash, e të vjelëtë djerie η së mbjellash. E u mā duo të mbaroj veprënë teme, Tinëzot tue pëlqem.*

12 *Meshari, botim kritik përgatitur nga E.Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f.387.

13 Dallimet që para së gjithash janë konceptuale mund të vihen re dhe në tekstet e shqipëruara, duke pasur parasysh se ndjekja e kësaj çështjeje në një vështrim diakronik që arrin te autorët e tjerë pasues bën të vihen në dukje ndryshime apo modifikime të

Emërtesa *Zot* ndeshet si në tekstet e Besëlidhjes së Vjetër ashtu dhe në ato të Besëlidhjes së Re e në pjesën e parë të librit ndeshet shpesh e në veçanti në përbërje të Psalmeve pendestare.¹⁴ Ky fakt ilustron si më poshtë:

Zot, mos më ndishko ndë furiel tande, as mos më kastigo ndë irët tande.¹⁵ **Zot**, ki mishërier në meje, përse u jam sëmuni; shëndoshmë, përse eshtënatë e mī lëngonjënë. E shpirti em anshtë turbuom fort. Ma ti, **Zot**, djerie kur të më apsh ndimë? Ktheu prej meje, **Zot**, e libero shpirtinë tem; e muo më shelbo për mishërier tande. Përse ndë mort s ashtë kush të bjere ndë mend për tÿ, as ndë ferët kush të të rëfyenjë. U punova ndë fshamë teme e për gjithë natë u shtratë tem me lot të mī u ta lā. U turbuo sytë tem në mëni; e u mplakshë ndër anëmiqt të mī. Dahi në meje ju gjithë bakëqī, përse Zotynë e gjegj zanë e vait tim. Zotynë e gjegj të lutunitë tem e Zotynë përzū oratënë teme. Klofshinë me mbarë e me të madhe mbarë klofshinë turbuom gjithë anëmiqtë e mī; u ktheshinë përhapëtë me mend të tyne, e klofshinë me mbare fort shpejrt. Lavdi kloftë Atit, e Birit, e Shpirtit shenjtë.¹⁶

Domine, ne in furore tuo arguas me neque in ira tua corripias me. Miserere mei, **Domine**, quoniam infirmus sum; Sana me, **Domine**, quoniam conturbata sunt ossa mea, et anima mea turbata est valde; sed tu, **Domine**, usquequo? Convertere, **Domine**, et eripe animam meam, salvum me fac propter misericordiam tuam. Quoniam non est in morte qui memor sit tui; in inferno autem quis confitebitur tibi? Laboravi in gemitu meo, lavabo per singulas noctes lectum, lacrimis meis stratum meum rigabo. Turbatus est a furore oculus meus, inveteravi inter omnes inimicos meos. Discedite a me omnes qui operamini iniquitatem, quoniam exaudivit **Dominus** vocem fletus mei. Exaudivit **Dominus** deprecationem meam; **Dominus** orationem meam suscepit. Erubescant et conturbentur vehementer omnes inimici mei; Convertantur et erubescant valde velociter.¹⁷

Ndeshet ky përdorim në raste kur funksioni i fjalës është vokativ dhe kjo ndodh në tekste të caktuara biblike. Duhet veçuar tekste në të cilat emërtimi **Zot** i drejtohet Krishtit. Të tilla raste nuk janë të rralla në librin e Buzukut:

rëndësishme ndaj kësaj nomenklature.

14 Në një vështrim përmbljedhës mbi përdorimin e këtij emri duhet thënë së pari që ka raste kur konotacioni i këtij përdorimi merr dhe diferencime sado të lehta. Siç dhe mund të vërehet nëse ndiqet në vijimësi panorama e shfaqjes së tij në tekstet e ndryshme të librit, referimi ndaj latinishtes *Dominus* në tekstet e BR bën të mendohet për një histori më të lashtë të vetë përdorimit, në kuptimin e një elementi parakristian që i përket një regjistri emërtimeve që kanë të bëjnë me hierarkinë si nocion.

15 Shih dhe siglën introductive përkatëse të këtij teksti: I pari asht kondra irësë, e thotë: Antifena. **Zot**, mos u kujto.

16 Meshari, *botim kritik përgatitur nga E.Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f.41/b-43/a.

17 *Psalmus*, 6, 2-11.

-Hinje një gruo qi ish në Kanēt, qi anso anësh ish ardhunë, thërit, tue i thashunë: Kī mishërrier në meje, **Zot**, i biri Davidit; bija eme fort anshtë munduom në dreqit.¹⁸

Et ecce mulier chananaea a finibus illis egressa clamavit dicens ei: miserere mei **Domine** Fili David; filia mea male a daemonio vexatur!¹⁹

-E i sëmuni ju përgjegj: **Zot**, u nukë kam nierī qi kur vëlizetë bëraka, të më lëshonjë mbrenda; por sa u vete, një tjetërë përpara muo hīn.²⁰

Respondit ei languidus: **Domine**, hominem non habeo ut cum turbata fuerit aqua mittat me in piscinam; dum venio enim ego alius ante me descendit.²¹

-E si hini Jezu ndë Kapernēt, erdh tek aj një krye në nierëzish, përndenë vetëhenë tue pasunë njëqind, tue u lutunë, e tue i thashunë: **Zot**, sherbëtori em keq jet ndë shtëpi, e fort anshtë munduom. E Jezu i tha: U të vinj e ta shëndoshinj. E ju përgjegj çenturioni, i tha: **Zot**, u nukë jam i denjë ti me hīm ndë shtëpi teme; ma pur thuo një fjalë të vetëme, e të jetë shëndoshunë sherbëtori em.²²

Cum autem introisset Capharnaum, accessit ad eum centurio rogans eum et dicens: **Domine**, puer meus iacet in domo paralyticus et male torquetur. Et ait illi: Ego veniam et curabo eum. Et respondens centurio ait: **Domine**, non sum dignus ut intres sub tectum meum, sed tantum dic verbo, et sanabitur puer meus.²³

Në disa raste ndeshet dhe përdorimi i shumësit *zota*. Bëhet fjalë për shembuj tipikë nga tekstet e Besëlidhjes së Vjetër:

-E tha Zotynë Moiseut: Ju patë se u fola me ju në qiellat. Ju muo mos më bani *zota* në rgjandi, as ju mos i bani t artë. Ma ju muo të më bani ltërë në dheu, e përmbi të ju të më epëni sakrificiatë e kafshëtë e paqit tij, e dhentë tuoj, e qetë taj mbë gjithë vend qi të promendetë emënitë tem.²⁴

Non facietis mecum deos argenteos nec deos aureos facietis vobis; altare de terra facietis mihi et offeretis super eo holocausta et pacifica vestra;

18 Meshari, *Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f.129/b.

19 *Evangelium secundum Matthaeum*, 15, 22.

20 Meshari, *Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f.131/b.

21 *Evangelium secundum Iohannem*, 5, 7.

22 Meshari, *botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.103/a. Shih dhe variantin tjetër që jepet më tej në libër, nga e njëjta pjesë e Ungjillit, por me diferencime të dukshme në trajta fjalësh të caktuara: Nd atë mot, tue hīm Jezu ndë Kafarnaut, erdh tek aj kryetë e një qind vete, tue lutunë, e tue i thashunë: **Zot**, sherbëtori em dergjet keq ndë shtëpi teme, e fort mondonetë. E Jezu i tha: U vinj e ta shëndoshinj. E tue i përgjegjunë çenturioni, i thotë: **Zot**, u nukë jam i denjë ti me hīm përndenë strehët të shtëpisë seme; mase një fjalë thuo, e të jetë shëndoshunë sherbëtori em. (Meshari, *botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.115/b).

23 *Evangelium secundum Matthaeum*, 8, 8.

24 Meshari, *botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.157/a.

oves vestras et boves in omni loco in quo memoria fuerit nominis mei.²⁵

-Nd ato dit foli Zotynë Moiseut: Stripë   malit, p rse populli uit u p rkat nuo, qi ti bane me dal    dheut s  Egjipit. Shpjert u dan    udhet qi u atyne pa   ordh nuom. Ata ban  nj  vi , e at   falen  me t  prunjun  e at  sakrifikuon , e i than : K ta jan  **zotat ** e tu, Israel, qi t  ban  me dal  jasht    dheut s  Egjipit.²⁶

Locutus est autem Dominus ad Mosen: vade, descende! Peccavit populus tuus quem eduxisti de terra Aegypti. Recesserunt cito de via quam ostendisti eis. Feceruntque sibi vitulum conflatilem et adoraverunt atque immolantes ei hostias dixerunt: isti sunt **dii** tui Israhel qui te eduxerunt de terra Aegypti.²⁷

Vend p r t u trajtuar mendojm  se ka dhe n  lidhje me p rdorime t  cilave n  variantet referenciale duhet t u p rgjigjet nj  nd rtim i zgjeruar, si   sht  rasti i *Dominus Deus*, p rdorur dhe n  tekstet latine n  disa forma paradigmatiche. Ka mjaft tekste, nj  pjes  e mir  e t  cilave nga *Bes lidhja e Vjet r* n  t  cilat mund t  gjurmohet zgjidhja q  i  sht  dh n  k tij p rdorimi mjaft dometh n s n  fush  t  teologjis  pik risht te *Meshari*:

- diglo, Israel, sod k t  dit  **Zot Zotn  tand**; t  ordh non ti t  veshte p r k to ligj  e k to t  d reja, e ti t  i mbash ato me gjith  zem r  tande e me gjith  shpirt tand.Ti bane me than  Tin zot se aj ansht  **Zoti uit Zot**, me ecun  mb udh  t  t  e me mbajtun  ligjet  e t  e ordh nin  e t  e gjyqet  e t , e me  digluom zanit t .E Zotyn  t  ban me t  than  sod se ti i je popull  at  p r t  ruojtun , porsi t  pat thashun , p rse ti t  mbash gjith  ordh nin  e t ; e p rse ti t  j sh p rmb  gjindn  qi aj bani, p r lavd t  madh e pr em n , e p rse t  jet  popull  shenjt **Tin zot Zotit tit**, si foli.²⁸

Hodie **Dominus Deus** tuus praecepit tibi ut facias mandata haec atque iudicia et custodias et impleas ex toto corde tuo et ex tota anima tua; Dominum elegisti hodie ut sit tibi Deus et ambules in viis eius et custodias caerimonias illius et mandata atque iudicia et oboedias eius imperio. Et Dominus elegit te hodie ut sis ei populus peculiaris sicut locutus est tibi; et custodias omnia praecepta eius et faciat te excelsiorem cunctis gentibus quas creavit in laudem et nomen et gloriam suam; ut sis populus sanctus Domini Dei tui sicut locutus est.²⁹

Nj  nd rtim i till  gjen vend dhe n  tekstin e m posht m nga libri i Eksodit, n  t  cilin gjejm  t  formuluar Dekalogun:

- nd r t t at  e t t am , p rse t  t  nglaten  ditt  e t  p rmb  dh t, qi **Zot Zoti uit** t  t ap  t . E mos  vra. E mos ban pun  t  p gлан . E mos

25 *Liber Exodi*, 20, 23-24.

26 *Meshari*, botim kritik i cituar, f.173/a.

27 *Liber Exodi*, 32, 7-8.

28 *Meshari*, botim kritik i cituar, Tiran , 1968, f.133.

29 *Liber Deutoronomii*, 26, 16-19.

vidh. E mos dëshmo rëshim kontra fqinjësë sate. E mos dëshëro shtëpinë e fqinjësë sate; e mos dëshëro gruonë e fqinjësë sate, as shërbëtorë, as shërbëtorinë, mos kanë e tî, as agërinë e tî, as ndonjë kafshë qi anshtë e fqinjësë sate.³⁰

Honora patrem tuum et matrem tuam ut sis longevus super terram quam **Dominus Deus** tuus dabit tibi. Non occides, non moechaberis, non furtum facies; non loqueris contra proximum tuum falsum testimonium; non concupisces domum proximi tui nec desiderabis uxorem eius; non servum, non ancillam, non bovem, non asinum, nec omnia quae illius sunt.³¹

Çështja e emërtimit të perëndisë në librin e Buzukut përbën një argument mjaft interesant, por dhe të rëndësishëm sepse bën të vihet në dukje dallimi apo diferencimi mes përdorimeve në këtë libër nga ato të mëvona, në veprat që e pasojnë atë. Mendojmë se mund të konstatohet se ka njëfarë lineariteti në përmbajtjen e *Mesharit* në lidhje me të tilla emërtime. Autori i librit pavarësisht dallimit që i bëhet emërtimit në fjalë në tekstet përkatëse biblike referenciale, përdor të njëjtat trajta. Në autorë të mëvonë një diferencim i tillë shihet se është realizuar në tekste të caktuara dhe që në përgjithësi kanë njëfarë përkimi me variantet referenciale që i vihen për krahasim. Bëhet fjalë në të vërtetë për një prej zgjidhjeve më delikate në drejtim të shqipërimit të përdorimeve themelore në fushë të leksikut të teologjisë së krishterë.

Emërtimet e hierarkisë mund të përfshijnë dhe përdorime të caktuara siç është dhe fjala *mjeshtë*, gjithnjë referuar Krishtit në tekstet e Besëlidhjes së Re:

-E shkruosinë e farizejtë i suollë përpara një gruo gjetunë me tjetërë burë. E si përpara e suollë, i thanë: **Mjeshtër**, këjo gruo u gjet me tjetërë burë. E ndë ligj a s ordhënoi Moiseu se gruoja qi të gjindë mbë këtë mëndyrë, ajo t ish me gurë mbëluom?³²

Adducunt autem scribae et pharisaei mulierem in adulterio deprehensam et statuerunt eam in medio et dicunt ei: **Magister**, haec mulier manifesto deprehensa est in adulterio. In lege autem Moyses mandavit nobis huiusmodi lapidare; tu ergo quid dicis?³³

- Nd atë mot, tue shkuom Jezu pā një nieri verbënë lenë. E atë pyetnë dishipujtë e tî, tue i thashunë: **Mjeshtër**, kush rā ndë kat, kÿ o ata qi e banë kÿ me lēm verbënë? E u përgjegj Jezu: As kÿ s kā rām ndë kat, as ata qi e banë; ma përse vepëratë e Tinëzot vinjënë n dritë ndë të.³⁴

Et praeteriens vidit hominem caecum a nativitate. Et interrogaverunt

30 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.157/a-b.

31 *Liber Exodi*, 20, 12-17.

32 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.167/b.

33 *Evangelium secundum Iohannem*, 8, 3-5.

34 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.177/a.

eum discipuli sui dicentes: **Rabbi**,³⁵ quis peccavit, hic aut parentes eius, ut caecus nasceretur? Respondit Iesus: neque hic peccavit, neque parentes eius, sed ut manifestentur opera Dei in illo.³⁶

Emërtime të ngjashme e të pranëvëna gjinden dhe në tekstin e mëposhtëm nga i njëjti libër (Krishti Mjeshtrë e Zot):

Ju më grëshitëni **Mjeshtrë** e **Zot**; e ju mirë thoni: përse u jam. E u në jam **Zot** e **Mjeshtrë** e u lava kambëtë tuoj, edhe ju të lani kambëtë njani tjetërit. Përse u juve këta ua bana, përse ju të xini; e si u bana, ashtu edhe ju.³⁷

Vos vocatis me magister et Domine, et bene dicitis: sum etenim. Si ergo ego lavi vestros pedes Dominus et magister et vos debetis alter alterius lavare pedes. Exemplum enim dedi vobis.³⁸

Në tekstet e librit të Buzukut ndeshet dhe emërtimi *regj*, që gjurmohet në tekstet që lidhen me nativitetin³⁹, por dhe në ato që i referohen Liturgjisë së Pashkëve.

-E tue pasunë gjetunë Jezu një agërë, rij përmbi të, porsi anshtë shkruom: Mos druoj, e bija e Sionit; hinje se **regji** uit vjen tue ndenjunë përmbi manzt të agërinjësë.⁴⁰

Et invenit Iesus asellum et sedit super eum, sicut scriptum est: noli timere filia Sion; ecce **rex** tuus venit sedens super pullum asinae.⁴¹

-E gjithë këta banë përse të mbaronë taç ish thanë në profetet, tue thashunë: Thoni së bijësë Sionit, qi do me thashunë Jeruzalemit: hinje se **regji** uit vjen tek ti përvutë, tue ndenjunë përmbi agërinjët me manzt përndenë të.⁴²

Hoc autem factum est ut impleretur quos dictum est per prophetam dicentem: dicite filiae Sion: ecce rex tuus venit tibi mansuetus et sedens super asinam et pullum filium subigalis.⁴³

35 Shih dhe *Nuovo Dizionario biblico*, a cura di René Pache, Edizioni Centro Biblico, Napoli, 1987, f.695: Rabbi, Rabboni. Dottore, maestro (colui che insegna): titolo rispettoso che gli Ebrei davano ai loro capi spirituali (Matt.23:7; Giov.1:38). Al tempo di Gesù, gli Ebrei distinguevano fra tre titoli onorifici: essi erano, a partire dal titolo inferiore: rab, maestro; rabbi, mio maestro; rabboni, mio Signore. All'epoca dell'apostolo Giovanni, il suffisso della prima persona (i) aveva perduto il suo significato particolare di pronomi possessivo, poiché Giovanni spiega che rabbi e rabboni significano semplicemente "maestro". (Giov.1:38; 20:16).

36 *Evangelium secundum Iohannem*, 9, 1-4.

37 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.219/a.

38 *Evangelium secundum Iohannem*, 13, 14-15.

39 *Meshari, botim kritik i cituar*, f.97/a: ...tue klenë lëtë Jezu ndë Betlemt të Judesë ndë dit të **regjit** Rod...

40 *Meshari, botim kritik i cituar*, f.199/b.

41 *Evangelium secundum Iohannem*, 12, 14-15.

42 *Meshari, botim kritik i cituar*, f.203/a.

43 *Evangelium secundum Matthaeum*, 21, 4-5.

Në libër ndeshen gjithashtu dhe emërtime të objekteve të kultit, në veçanti në disa pjesë biblike të tij. Këto emërtime ndeshen të përmendura shpesh veçanërisht në pjesët më të gjata në pikëpamje tekstologjike. I tillë është rasti i *Passionës* që në libër përshkruhet në disa variante nga Ungjihtë.

Sa u përket këtyre emërtimeve të objekteve të kultit, dhe këto duhen parë në kontekstin përkatës të përdorimit dhe sigurisht në qasje me të tjera variante referenciale. Autori përdor emërtimin **klishtë** në disa vende, në mjaft pjesë të librit. Ky përdorim rezulton të jetë më i shpeshtë se përdorimi i emrit *sinagogë*.⁴⁴

Nd atë mot vote Jezu mbë malt të Ullinjet. E përhapë ndënatatet herëjet erdh **m klishtë**, e gjithë populli uinjinë tek aj; e aj tue ndenjunë ata mpon.⁴⁵

Jesus autem perrexit in montem Oliveti et diluculo iterum venit **in templum** et omnis populus venit ad eum et sedens docebat eos.⁴⁶

Të tilla gjurmime në librin e Buzukut orientojnë drejt një arsenali fort të pasur elementesh leksikore dhe ndonjëherë dhe me vlerë ndërtimesh sintagmatike⁴⁷. Përfshihen në të pjesë të ndryshme të ligjëratës si dhe familje të tëra fjalësh që bëjnë jo vetëm të gjurmohet rruga e formimit të secilës prej tyre, por dhe lidhjet semantike që jo rrallë në këtë vepër shfaqen për vetë stilin e shkrimit të tij, që i qas të tilla fjalë, të vëna ndaj njëra-tjetrës në raporte afrie kuptimore, kundërshtie kuptimore, por dhe lidhesh derivacioni.

Një pjesë e mirë e tyre kanë vijuar të përdoren si në liturgjinë e krishterë ashtu dhe në praktikën fetare përkatëse. Përdorime tipike të kësaj fushe mbeten raste si: *Regjinia/Regjēnia, mishëriera*⁴⁸, *i përmishëriershim, hiri*⁴⁹, *hirplota, vollundetja, pushtedja, lteri, oferta, shenjt/shenjte/shenjhtënuem*,

44 Siç mund të vihet re dhe te shembujt përkatës, emri *klishtë* përdoret dhe kur në tekste referenciale mund të jetë emri *templum*. Një fakt i tillë përforcohet dhe kur u referohemi përdorimeve të ngjashme në veprën e Pjetër Bogdanit. Në rastet kur kemi gjurmuar përdorimin e emrit *sinagogë*, dhe në tekstin latinisht gjindet i njëjti gjegjë: E lypnjënë e duonë kryetë e tryesëvet mbë darkë, e të parëtë shqemb **ndë sinagogët**, e të ñfalë të madh ndë trigjet, e duonë me klenë grishunë mjeshtë. (*Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.139/a.) /Amant autem primos recubitos in cenis et primas cathedras **in synagogis** et salutationes in foro et vocari ab hominibus rabbi. (*Evangelium secundum Matthaeum*, 23, 6-7.)

45 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.167/b.

46 *Evangelium secundum Iohannem*, 8, 1-2.

47 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.113/a: E gjithë populli, si këta pënë, **dhanë lavd Tinëzot**. (Et omnis plebs ut vidit, dedit laudem Deo; Lc 18, 43).

48 *Mishërierë*: zakonisht kësaj fjale i përgjigjet femërorja latine misericordia. Bashkë me mbiemrin *i përmishëriershim* përbëjnë fjalë mjaft të përdorura në përbërje të librit. Mbiemri *i përmishëriershim* ka një përdorim tipik në mbyllje të librit, ndërsa vihet krah përdorimeve të tjera me vlerë mbiemërore: *i mujtunë, i naltë*.

49 Shih ndër të tjera te *Meshari* dhe këtë përdorim: *Hiri, tÿ, Zot, kloftë...* (*Meshari, botim i cituar*, f.107/a).

santifikonj, të shëkruomitë⁵⁰, e shëkruome; shelbonj, shelbuom, të shelbuomitë⁵¹, shelbuosi, feja⁵², profet/përfetë, përfetixonj/profetixonj; ngjënjonj⁵³, të ngjënuomitë, ngjënimi;⁵⁴ të lutuna, oratë etj.

Citojmë dhe emërtime tipike të një regjistri leksikor që mbizotëron në pjesë të caktuara të librit të Buzukut, në lidhje të cilat mund të ndiqet dhe ndonjë linjë e modifikimit kuptimor edhe brenda vetë teksteve të librit, edhe në variante të veprave të mëvona në pikëpamje kronologjike: *psalma, hymna, kanka, responsoria, antifena;⁵⁵ devocionë, sakramentatë; rëfnyenj; sakrificio; sakrificiatë; holokausta; ostia; tabernakullë; fëje/kat; i përkatënuom; i pākat; kulpë⁵⁶; Passiona⁵⁷; Rrshajë⁵⁸/Pentecostes⁵⁹ etj.*

Emërtesat që lidhen me sakralen të shprehura qoftë dhe me trajta që më tej do të kenë prirjen të orientohen falë një procesi evolutiv drejt sintetizmit, ofrojnë veçanërisht mundësi qasjeje me autorët pasardhës

50 Nð atë mot u ba të Shëkruomitë e rī m Jeruzalem të klishësë; e ish ndë dimënë. (*Meshari, botim kritik i cituar*, f.193/b).

51 *Meshari, botim kritik i cituar*, f.: Dëftona, Zot, mishërierë tande, e neve na ep **të shelbuomitë** tat.

52 *Fe e besë* përdoren të dyja në tekstet e *Mesharit* të Gjon Buzukut. Një fakt i tillë vihet re ndër të tjera dhe kur qasen variante mes tyre të ndryshme në drejtim të disa tipareve gjuhësore, por që në përmbajtje përfaqësojnë të njëjtën pjesë biblike. Një tekst nga *Ungjilli simbas Matheut* (18, 5-13) ndeshet më se një herë në librin e Buzukut (përkatësisht f.103/a; 115/b në botimin kritik këtu të cituar) dhe një prej dallimeve qëndron pikërisht në faktin se përdoret fjala *fë* (f.103) në njërin variant e mandej për të njëjtin kuptim gjegjës fjala *besë* në variantin tjetër(f.115). Mbi përdorimin e emrit *fe* shih në veçanti *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.113/a: E Jezu tha atë: Këqyrë, përse **feja** jote tÿ shelbou./ Et Iesus dixit illi: Respice, **fides** tua te salvum fecit.. (Lc 18, 42).

53 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.113/b: E ti kur **të ngjënjonsh**, lyej kryetë tat e laj faqenë tande, përse mos dukësh nierëzet se **ngjënjon**.(Tu autem cum ieiunas, ungue caput tuum et faciem tuam lava, ne videaris hominibus ieiunans.; Mt 6, 17)

54 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.113/a: Oratio: Zot, na ep ndimënë popullit kërshenë, na tue zanë **ngjënimnë** shenjtë, përse na mundë qëndrojmë kontra tentacionet të shpirtit, e për këta **të ngjënuom** na klofshim defenduom.

55 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.105/b.

56 *Meshari, botim kritik i cituar*, f.163: Epna neve, tÿ lusmë, o i mujtuni Zot, ata qi mishtë e tyne me të ngjënuom mundonjënë, ata tue u mbajtunë n alimentashit, ata tue ndjekunë të dërejtënë, e **n kulpet** së tyne ata ngjënoshinë. Për tenë Zonë Jezu Krishtnë Birë tand.

57 *Meshari, botim kritik i cituar*, f.203/b.

58 *Meshari, botim kritik i cituar*, Tiranë, 1968, f.265/a: Nð ato dit mbe e mbaruomit të ditësë **Rshajevet**, ishnë gjithë dishipujtë njëj zemëre mb atë vend të vetëmë./Et cum complerentur dies **pentecostes**, erant omnes pariter in eodem loco.. (*Actus Apostulorum, Capitulo secundo*, 2, 1.).

59 Për përdorimin e të dyja emërtesave te *Meshari* shih në veçanti në botimin kritik të cituar më sipër, f.263/a-b, paragrafet Sabbato in vigilia pentecostes; In die pentecostes; Ecë e vgjaj të parënë të diel mbas Rshajesh..

të Gjon Buzukut. Jo pa rëndësi mbetet gjurmimi i fushës semantike të sakramendeve dhe i familjeve të fjalëve në të cilat përfshihen përdorime të caktuara. Mbetemi të mendimit që duhen vlerësuar prurjet nga leksiku latin i krishterë, duke qenë ky i fundit si ndër më të vlerësuarit në studimet që kanë në qendër të vëmendjes tyre regjistrin liturgjik dhe elementet më specifike të tij në pikëpamje semantike dhe të historisë së fjalës.

Duke mos përjashtuar dokumentet e njohura parabuzukiane që gjithsesi për ndonjë përdorim të caktuar dëshmojnë shkallën e modifikimit fonetik dhe si rrjedhim dhe lashtësinë e përdorimit përkatës ndër shqiptarë, te Buzuku duhet parë pikënisja e një historiku që përfshin mjaft elemente të rëndësishme të leksikut të liturgjisë dhe të vetë teologjisë biblike, për sa mundet një libër i atij modeli t'i përmbajë të tilla përdorime.

Abstract

The essay centres around the liturgical lexicon of Gjon Buzuku's *Meshari*. The author has drawn on specific parts of *Meshari*, especially, from *Officium*, the *Psalms* and other parts of the book. Terminology in prayers and biblical parts of *Meshari* could not possibly escape meticulous examination either.

Specific nomenclatures in the *Meshari* are also carefully reported such as names of God, names of sacred cult objects and other elements connected to them. Furthermore, linguist Paci investigates several elements of liturgical terminology in the tradition of Albanological studies, e.g. the continuity of specific nomenclatures in successive authors.

Lastly, the essay emphasizes the importance of *Meshari*, as it inspired and promoted further liturgical lexicon in written Albanian.

BIBLIOGRAFI

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, Shkodër, 1996.

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1998.

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe III*, Tiranë, 2000.

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2002.

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe V*, Shkodër, 2009.

- Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe VI*, Shkodër, 2012.
- Blaise A., *Manuel du latin chrétien*, Brépols, Strasbourg, 1955.
- Blaise A., *Le vocabulaire latin des principaux thèmes liturgiques (ouvrage revu par D.Antoine Dumas O.S.B.)*, Brépols, 1966.
- Boerio G., *Dizionario del dialetto veneziano*, Reale Tipografia di Giovanni Cecchini, Venezia, 1867.
- Budi P., *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R.Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes II, A-B*, Tiranë, 1976.
- Çabej E., *Vepra e Gjon Buzukut në vështrim historik e gjuhësor, në Studime filologjike*, n.1, 1979.
- Çabej E., *Shqipja në kapërcyell: Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes VII*, Tiranë, 2006.
- Çabej E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- Çabej E., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Botime Çabej, Tiranë, 2013.
- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes V*, Botime Çabej, Tiranë, 2014.
- Demiraj B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- Ebner M., Schreiber S., *Introduzione al Nuovo Testamento*, Queriniana, Brescia, 2012.
- Eisenhofer L., Lechner J., *Liturgia romana*, Marietti editore, Torino, 1970.
- Ismajli R. *Tekste të vjetra*, Dukagjini-Pejë, 2000.
- Lécureux B., *Le latin, langue de l'Église*, Éditions Spes, Paris, 1964.
- Maisano R., *Filologia del Nuovo Testamento*, Carocci editore, Romë, 2014.
- Mohrmann Ch., *Le latin liturgique*, La Maison-Dieu, n.23, 1950.
- Paci E., *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare, në Hylli i Dritës*, n.2, 2011.

- Paci E., *Për një vështrim tekstologjik të Mesharit të Gjon Buzukut*, në *Hylli i Dritës*, n.3, 2011.
- Paci E., *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011.
- Paci E., *Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzukut*, në *Hylli i Dritës*, n.4, 2012.
- Paci E., *Elemente të leksikut të liturgjisë në veprat e letërsisë së vjetër shqipe-Zotynë si rast studimi*, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2014.
- Paci E., *Cenni ed osservazioni linguistiche sul primo libro scritto in lingua albanese(1555)*, në *Studia Albanica*, 1-2, 2014.
- Paci E., *Çështje të gjurmimit të elementeve latine në veprat e letërsisë së vjetër shqipe*, në *Fjala hyjnore*, n.2, 2014.
- Petrotta G., *Popolo, lingua e letteratura albanese(a cura di M.Mandalà)*, Edizioni Mirror, Palermo, 2003.
- Ressuli N., *Il "Messale di Giovanni Buzuku", (riproduzione e trascrizione)*, Biblioteca Apostolica Vaticana, Romë, 1958.
- Ressuli N., *I più antichi testi albanesi*, G. Giappichelli, Torino, 1978.
- Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.
- Traets C., *Orientations pour une théologie des sacraments*, në *QL*, n. 53, 1972.
- Zamputi I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1995.
- Zamputi I., *Mbi disa fjalë të kristalizueme në lutjet e në praktikën fetare katolike*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1996.